

Datë 11.05.2026

**KONSULTIM PUBLIK**

*Njësia Administrative Xhafzotaj*

Tema: "Projekti parë i Buxhetit 2027 – 2029"

Nr	Emër	Mbiemër	Vendbanimi	Tel	Firma
1	Razim	Domi	Metyllaj	0682265509	<i>[Signature]</i>
2	Kastriot	Seferi	Budinok	0683167832	<i>[Signature]</i>
3	Fiqari	Amri	Belalej	0682270925	<i>[Signature]</i>
4	Kulzum	METALIU	YLLASHAJ	0682060123	<i>[Signature]</i>
5	Noson	Loja	Ponivoll	0682137705	<i>[Signature]</i>
6	Albent	Juska	Shtnaz		<i>[Signature]</i>
7	Adminim	BULLKU	Cizmeli	0692452507	<i>[Signature]</i>
8	Ramiz	Zyloq	Gjoketaj	0686199487	<i>[Signature]</i>
9	Mustafa	Mushe	Shtkoq.	0683722873	<i>[Signature]</i>
10	Beshkri	Qaradaj	Likosh	0697810064	<i>[Signature]</i>
11	Blicim	tuda	Shtetel	0692763062	<i>[Signature]</i>
12	Rais	Bullku	Gimeli	0683347789	<i>[Signature]</i>
13	Agron	Voci	Karpen	0682457075	<i>[Signature]</i>
14	Mirhamet	Meccec	0682809734	Flloke	<i>[Signature]</i>
15	Nisken	Gjoka	069211517	Iliazim	<i>[Signature]</i>
16	Benta	Mushu	0676340044	Shajk	<i>[Signature]</i>
17	Uendi	Dyrimishi	0692321115	Xhafzotaj	<i>[Signature]</i>
18	Leonard	Çallhaj	0686335801	Kënetë	<i>[Signature]</i>
19	Muhamed	Preku	Skriçaj	0692401087	<i>[Signature]</i>
20	Ramazan	Konavr	Emine	0696951995	<i>[Signature]</i>
21	Elson	Ketaj	Xhafzotaj	0692860777	<i>[Signature]</i>
22	Alcin	Bici	Xhafzotaj	0684040857	<i>[Signature]</i>
23	Flamur	Redi	Xhafzotaj	0695891926	<i>[Signature]</i>
24	Shqip	Qaradaj	Prez	068212757	<i>[Signature]</i>
25	Figjiri	Jellari	BORAKE	0672036042	<i>[Signature]</i>
26					
27					
28					
29					
30					

Njësia Administrative Xhafzotaj – ora 17:00

Tema: 1. “Projekti I parë I Buxhetit afatmesëm 2027-2029”

Sulejman Tola (Kryetar I Këshillit): Ju falenderoj të gjithë për pjesëmarrjen në këtë konsultim Publik mbi Projektin e parë të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029. Fjalën ja ajp drejtoreshës Ekonomike Znj. Pranvera Alushi të na relatojë mbi materialin dhe më pas mirëpres cdo koment tuajin.

Pranvera Alushi (Drejtoresha Ekonomike): Pershendetje!

Buxheti i miratuar ne dhjetor 2025 per vitin 2026 eshte 987,027 leke te reja. Ky ka qene buxheti me i mire qe Bashkia ka patur. Shpenzimet per Investime per PBA 2026-2028 ne total do te jene pothuajse dyfishin e tyre krahasuar me vitin 2025. Prioritare do të jene investimet e programit te Transportit ( Infrastruktures Rrugore), te cilat ne tre vitet bashke 2026-2028 do te zene 85 %,96 %,89 % brenda zerit te investimeve , ndersa ndaj totalit te buxheteve kemi 37 %,41%, dhe 38% per vitin 2028.

Investimet jane si me poshte :

- 1.Rehabilitimi I rrugëve ne Lagjen Karrec Njësia Administrative Maminas.
- 2.Rehabilitimi i 3 Rrugëve ne njesine e Bashkise Shijak Rruga Gjepalaj e poshtme, rikonstruksion i rruges e “Laleve” dhe rikonstruksion i sheshit Shijak.
- 3.Rikonstruksion I 5 rrugëve te brendshme, ne njesite Bashkia Shijak (Rruga Dum Alla, Rruga Oksigjenit, Rruga Koceve ne Rrubjeke, Rruga varrezave ne fshatin Vlashaj, rruga ne Terzie me KUZ).
- 4.Rikonstruksion, sistemim-asfaltim rruga ‘Auto fshati Shetel’ Njësia administrative Gjepalaj.
- 5.Sistemim-asfaltim I rrugëve “Cizmeli-Eminas” Njësia administrative Gjepalaj.
- 6.Riparim I shtresave asfaltike rruga Hardhishte-Gjepalaj, Njësia administrative Gjepalaj.
- 7.Riparim I shtresave asfaltike rruga “Gani Keta”, Bashkia Shijak.
8. Riparim I shtresave asfaltike rruga “Djerri-Rezervuari Metallaj, Njësia administrative Maminas.

9.Sistemim,asfaltimi I rrugëve ne “lagjia e re Bodinok & lagjia e re Metallaj”, Njesia administrative Maminas.

10.Sistemim asfaltim I rruges “Mustafa Bulku” Njesia administrative Xhafzotaj.

Keto jane investimet per buxhetin afatmesem,nese keni ndonje sugjerim jemi ketu per tju degjuar.

Fiqiri Kllari (Borake):Përmendët shumë gjëra por nuk pashë asgjë për ndërtimet.Në Borake kemi jërat e zeza,200 e ca metra ujra të zeza.Kemi një pjesë rreth 50 ha tokë poshtë hekurudhës dhe sipër hekurudhës që nuk kanë rrugë.U përmend asfaltimi I rrugës,STARI Borak nuk u përmend fare.Rrugët janë copë copë.Për bujqësinë nuk u përmend asnjë lloj investimi.Jam I vetmi në rrethin e Durrësit që kam 150 ha tokë.Rreth 57 ha janë të STARI Borak dhe pjesa tjetër rreth 90 ha në Borake dhe Koxhas.Stacioni I trenit po bëhet i ri,është në territorin e Shijakut,pse most ë bëhet një kërkesë që Sukthi të jetë I Shijakut.Nuk të fal kush territor sot.Sukthin ta marri Shijaku.

Pranvera Alushi:Për sa I përket rrugëve kemi fonde rezervë,do ja dërgojmë urbanistikës.Në qershor do të bëjmë rishikim buxheti.Do të vendoset me përparësi nga grupi I punës që merret me prioritetet.Për reformën territoriale nuk janë bërë akoma dëgjesa publike për zonën tonë.Kryetari po lobon fort.

Shpresa Domi(zv.kryetare):Do të njoftoheni për dëgjesat publike.

Kastriot Seferi (Bodinok):Një pjesë të rrugës në Bodinok të Sipërm e kemi të pashtuar.Kodra e Bodinokut,rruga e varrezave e kemi mjaft të vështirë,po izolohet fare.Nga Metallaj-Bodinok të hidhet pak cakull të paktën.

Fiqiri Alushi (Bilalasi):Bilalasi nuk figuron fare në listën e investimeve.Ka 10 vite që nuk është bërë asnjë investim.

Shpresa Domi:Bilalasi është në project për investime.

Muhamed Plaku (Eminasi I vogel): Azhornimi i tokave,dua të bej letrat e tokës por janë të paazhornuara.

Mustafa Tusha (Shtrazë):Fshati Shtraze nga varrezat deri tek rruga me asfalt,është rreth 1 km rrugë e paasfaltuar.Është rrugë mjaft e vështirë nuk kalohet në dimër.

Flamur Dedja (4-Rrugët): Në gjithë zonën e 4-rrugëve nuk është bërë një trotuar,as në drejtim të Rrethit as në Sallmonaj as në drejtim të Durrësit.Rruga që shkon tek Filanto rreth 1 km rrugë,janë 112 shtëpi.Rruga është mirëmbajtur nga unë,duhet vetëm asfalti.Dalin ku shkon tek stallat e reja,tek Vort,kanalet vaditëse janë mbushur me mbeturina.Varreza për Xhafzotaj nuk keni më.Janë Xhafzotaj dhe Sallmonaj bashkë.Mbi 4000 banorë ka Sallmonaj,e gjithë Xhafzotaj ka 16,800 banorë.

Arlind Bici (anëtar këshilli): E vetmja zgjidhje është toka e varrezave të vjetra. Janë rreth 6000 metra. Si anëtar këshilli unë jam marrë më shumë me këtë problematikë.

Banor i Vllazërimit : 1. Tek 4 rrugët e Fllakës kemi problem një rrethrotullim. Shumë viktima kemi patur nga mungesa e atij rrethrotullimi.

2. Segmenti nga 4 rrugët Fllakë – Shkolla Bajram Gashi duam një trotuar në një anë të rrugës sepse rrezikohen nxënësit. Aty ecet me shumë shpejtësi.

3. Pastrimet e kanaleve, sa herë bie shiun a hyn uji në shtëpi. Unë po flas për zonën që kap Shijaku. Ne taksat po i paguajmë, na ofroni shërbim.

4. Legalizimet, ka 8 vite që janë premtuar legalizimet nga Bashkia por letrat nuk i kemi marrë.

Ramiz Tuda (Shetel): Kur do të fillojë rruga në Shetel, se Sheteli është zona më e prapambetur në Shijak.

Agron Voci (Karpën): Prroi I madh në Karpën të lahet, ka shkuar gjërësia 1 metër e gjysëm. Na janë përmytur tokat nga ngushtimi I përroit. Dhe të paktën na hidhni cakull në Karpën.

Nikoll Gjoka (Vllazërim): Lidhja e banesave me rrugën automobilistike është 1700 metra. Në atë rrugë ka 3 bllokime kanali, aty përmytet. Rruga Ibrahim Pupla, rruga Ish Radiostacioni te shihet ku janë bllokuar.

2. Lirim E tokave publike.

3. Keni bërë projekte pork u janë investimet.

3. Nuk kemi ambulancë në Vllazërim, banoret shkojnë në Xhafzotaj.

Sulejman Tola: Të gjitha rekomandimet tuaja do ti përcillen Kryetarit të Bashkisë dhe administratës për tu marrë në konsideratë

Ju falenderojmë për pjesëmarrjen!

**KOORDINATORI PËR KONSULTIM PUBLIK**

Fabiana Keçi



*Bashkelidhur fotot e Konsultimit Publik!*

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

Kozeta Doda







